

Rezultatet e konsultimit publik për projektligjin “Për Bletarinë”

1. Titulli i draft aktit

Projektligj “Për Bletarinë”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Hartimi i projektligjit është iniciuar me kërkesën e vazhdueshme të Federatës së Bletërritësve të Shqipërisë dhe Shoqatave lokale të tyre, në të gjitha takimet dhe aktivitetet që zhvilloheshin me ministrin e bujqësisë për sektorin e bletarisë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për këtë sektor me rëndësi jetike, si dhe përcaktimin e rregullave dhe kushteve të regjistrimit, transportit, shtegtimit, mbrojtjes dhe kontrollit të produkteve të bletarisë.

Ky sektor është prekur në legjislacionin e blegtorisë, të veterinarisë, të sigurisë ushqimore, por që bën të pamundur leximin dhe zbatueshmërinë nga ana e bletërritësve..

Me Urdhër të Ministrit Nr. 543 datë 21.10.2021, u ngrit Grupi i Punës, për hartimin e projektligjit, me përfaqësues të:

- Drejtorisë së Politikave të Bujqësisë dhe asaj të Veterinarisë;
- Shërbimit Këshillimor;
- Universitetit Bujqësor të Tiranës;
- Shoqatave dhe Federatës së bletërritësve;
- Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Draftligji ka përafruar dy rregullore të BE-së, duke konsideruar si modele ligjin Italian dhe atë Kosovar.

Hartimi i tij, ka qenë gjatë gjithë kohës në konsultim me grupet e interes, pavarësisht se ata ishin vetë të përfshirë në grupin e punës.

Fillimisht nga Grupi i Punës u hartua një listë me ekspertë të fushës së bletarisë, të cilëve ju shpërnda për mendim draftligji.

Kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të projektligjit, përfshirë konsultimet e vazhdueshme gjatë hartimit dhe konsultimin publik ka qenë nga data 21.10.2021 deri më datë 8.11.2022. Në këtë afat përfshihen, takimet e grupit të punës, takimet dhe konsultimet me ekspertët e fushës, mendimet e Ministrive të Linjës, si edhe konsultimi përmes regjistrit elektronik.

Nga data 24.4.2022 deri në datë 23.5.2022, draftligji “Për bletarinë”, së bashku me relacion shpjegues janë publikuar për konsultim publik në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik në ëëbsite <http://www.konsultimipublik.gov.al>. Gjatë këtij procesi nuk ka pasur komente.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për Bletarinë”, ishin:

- konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik, RENJK, nga 24.4.2022 deri në datë 23.5.2022;
- komunikimi përmes postës elektronike gjatë gjithë fazës së hartimit të draftit të projektligjit;
- takime të vazhdueshme (edhe online) me ekspertët e fushës;
- takime të vazhdueshme të grupit të punës;
- marrja e mendimeve nga ministritë e linjës.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në hartimin e projektligjit, janë:

- Shoqatat e Bletërritësve Lokalë, Korçë, Vau i Dejës;
- Federata e Bletërritësve të Shqipërisë;
- Profesorë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe Universitetit Aleksandër Xhuvani Elbasan;
- Gazetarë;

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Duke qenë se procesi i hartimit të projektligjit ka qenë një proces dinamik dhe grupet e interesit kanë qenë të përfshira në hartimin e dokumentit komentet/sugjerime e tyre janë marrë parasysh gjatë procesit të hartimit.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (pranuar/ pranuar pjesërisht /refuzuar)	Justifikimi
Përkufizime/Terminologji	Në Bletarinë shtegtuese, te shtohen në plantacione dhe serrat ;	Manjola Kuliçi, Pedagoge, UBT	Pranuar	Neni 2, pika 6
	Parku i bletëve të ndryshojë përkufizimi mos të përdoret termi në tërësinë..		Pranuar	Neni 2, pika 10
	Të shtohet përkufizimi për Zgjuar;		Pranuar	Neni 2, pika 29

	Të jepen shpjegime për ligjin „Për mbarështimin e Blegtorisë“; Rëndësia e sektorit Përkufizimi për bletar, që mund të jetë dhe ai që s’bën pjesë në shoqatë; Të zëvendësohet koshere me zgjua; Të përdoret vetëm termi „mjaltë“, jo :mjaltë natyral“ Termi mbretëreshë”, të zëvendësohet me termin “amë” ose “mëmë”. Fusha e zbatimit të jetë më e gjerë. Perkufizim Bletar profesionist	Ilir Bala Gazetar Abdyl Arifaj Kledian Kosturi	Refuzuar Pranuar Refuzuar Refuzuar Refuzuar Pranuar Pranuar	Në përkufizime citohet vetëm baza ligjore. Neni 4 Nga kuptimi i dhënë duhet të jenë të dyja konceptet. Janë vendosur të dyja Nga përkufizimi i referohet vetëm termit të prodhimit të mjaltit nga lulet. Referuar përdorimit dhe traditës përdor termi dhe sqaruar që nënkuptom mëmën e kolonisë Neni 3 Neni 2, pika 9
Regjistrimi	Të përcaktohet vendi se ku duhet të regjistrohet bletari; Të mos vendoset në përkufizim për “Bletarin”, regjistrimi në Shoqatën Lokale të Bletërritësve, si dhe të mos përfshihet në projektligj, regjistrimi në Shoqatën Lokale të	Manjola Kuliçi, Pedagoge, UBT Eksperti Veterinarisë	Pranuar Refuzuar	Neni 6, pika1 Rëndësia e sektorit të bletarisë; Përhapja e shpejtë e sëmundjeve edhe nga një koshere e vetme; njohuritë mbi marrjen e masave

	Bletërritësve, I numrit të koshereve Nëse nuk është I regjistruar në Shoqatën Lokale të Bletërritësve të mos regjistrohet në regjistrin e fermës dhe atë të blegtorisë; Të regjistrohet në SHLK;	Jak Pacani SHLB Korçë Abdyl Arifaj	Refuzuar Pranuar	për të ruajtuar shëndetin e konsumatorit; Regjistrimi në shoqatë është detyrim i bletarëve dhe nuk mund të kufizojë regjistrimin sipas ligjit. Neni 6, pika 1
Vendndodhja	Të detajohet vendndodhja e parkut pranë fabrikave dhe të ndalohen aktivitetet afër tyre	Manjola Kuliçi, Pedagoge, UBT	Pranuar	Neni 7, pika 4 & 5
Shtegtimi	Të shtohet shmangia e kushteve të pafavorshme klimatike; Të shtohet distanca nga parqet e tjera; Kërkesë për shtegtim tek Shoqata. Distanca 50m Të përcaktohet koha për përgjigje	Manjola Kuliçi, Pedagoge, UBT Jak Pacani SHLB Korçë Ilir Bala	Pranuar Pranuar Refuzuar Pranuar Pranuar	Neni 8, pika 1 Neni 8, pika 6 Shtegtimi bazuar në studimin që kryhet në bashk. me shoqatën. Neni 8, pika 6 Neni 8, pika 2
Transporti	Të specifikohen mjetet e transportit që të jenë të mbyllura dhe të shoqërohen nga bletërritës me veshje dhe pajisje mbrojtëse; Të mos ndalohen më shumë se 30 minuta;	Manjola Kuliçi, Pedagoge, UBT Jak Pacani SHLB	Pranuar Pranuar	Neni 9, pikat 1,2,3 Neni 9, pika 4

		Korçë		
Riprodhimi	Të specifikohen nënlojet; Të ngrihet një autoritet për kontrollin e racavetë tjera të bletëve	Manjola Kuliçi, Pedagoge, UBT	Pranuar Refuzuar	Neni 10, pika1 AKU kryen kontrollin sipas legjislacionit.
Mbrojtja	Të përdoren PMV në sasinë e rekomanduar nga mjeku veterinar;	Manjola Kuliçi, Pedagoge, UBT	Pranuar	Neni 12, pika 2
	Bletari duhet të mbajë një regjistër për trajtimet mjekësore që ju kryhen bletëve;		Pranuar	Neni 12, pika 3
	Mbrojtja nga fatkeqësitë të specifikohet për kompanitë e sigurimit;	Jak Pacani SHLB Korçë	Refuzuar	Nuk detyrojmë kompanitë e sigurimit.
	Mbrojtja nga përdorimi i PMB në momentin e lulëzimit.		Pranuar	Neni 16, pika 1
	Mbrojtja nga fatkeqësitë të zbatohet sigurimi villnetar;	Ilir Bala	Pranuar	Neni 12, pika 9
	Për shkak të pestave amerikane duhet zhdëmtuar kur provohet;	Abdyl Arifaj	Refuzuar	Sipas përcaktimeve të legjislacionit për veterinarine;
	Qarkullimi dhe tregtimi i mëmave duhet të jetë detyruesisht i certifikuar;		Refuzuar	
	Shtegtimi të kryhet me miratim të SHLB	Kledian Kosturi	Refuzuar	Studimi do hartohet me Soqatat
Raportimi	Raportimi për numrin e koshereve dhe vendndodhjen apo ndryshimin e tyre duhet bërë në fund të muajit	Manjola Kuliçi, Pedagoge, UBT	Pranuar	Neni 14, pika 1

	prill, pra pas dimërimit; Raportimi të bëhet në shoqata; Pranë çdo bashkie të caktohet një veteriner duke i njohur shpenzimet e firmosura nga SHLB; Nuk duhet ndjekur kurs kualifikimi për bletarët e rinj;	Jak Pacani SHLB Korçë Ilir Bala	Refuzuar Refuzuar Refuzuar	SHLB do të informohen nga institucioni përgjegjës sipas pikës 1, nenit 14; Buxheti i bashkive dhe numri i stafit miratohen me legjislacion të veçantë. Mbrojtja e sigurisë së konsumatorit dhe mospërhapja e sëmundjeve domosdoshmëri kualifikimin
Bletaria Biologjike	Përkufizim	Jak Pacani SHLB Korçë	Refuzuar	Sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre“;
Etiketimi	Të shtohet në etiketë dhe natyraliteti sipas polenëve; Afati i përdorimit 36 muaj	Blerina Pupuleku Kledian Kosturi	Refuzuar Refuzuar	Shtesë jo e nevojshme për etiketë. Afati për ruajtjen e cilësisë 24 muaj. Mjalti nuk prishet pas këtij afati, por disa nga vetitë humbasin
Pjalmimi natyral	Të gjitha produktet të qarkullojnë në treg të shoqëruar me fletë	Jak Pacani SHLB Korçë	Refuzuar	Detyrimetë përcaktuara në legjislacionin

	analiza			përkatës për veterinarinë;
Ruajtja	Lagështia relative e ajrit e lartë.	Manjola Kuliçi, Pedagoge, UBT	Pranuar	Neni 27
Mbështetja	Të gjithë bletarët duhet të kenë mbështetje financiare sipas moshës dhe gjinisë	Jak Pacani SHLB Korçë	Refuzuar	Janë kritere që vendosen në masat e mbështetjes.
Pëpunimi	Të specifikohet kush do të regjistrohet në QKB	Jak Pacani SHLB Korçë	Refuzuar	Flitet për subjekte përpunuese.
Mbikqyrja	Të kryhet nga inspektorët e bashkive	Jak Pacani SHLB Korçë	Refuzuar	Do të kryhet nga inspektorët e AKVMB sipas përcaktimeve ligjore për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve.
Kundërvajtjet	Mosregjistrim pranë shoqatës	Jak Pacani SHLB Korçë	Pranuar	Neni 29, pika 1

Tabela e komenteve sipas grupeve të interesit:

Nr.	Subjektet	Data	Nr. Komentesh	Pranuar	Refuzuar	Dakortësuar
1	Manjola Kuliçi	16.3.2022	16	14	2	Po
2	Jak Pacani	15.3.2022	12	2	10	Po
3	Ilir Balla	15.3.2022	9	1	8	Po
4	Lumturi Sena	13.3.2022	2	2		Po
5	Abdyl Arifaj	11.3.2022	3	2	1	Po
6	Blerina Pupuleku	11.3.2022	1		1	Po
7	Kledian Kosturi	15.3.2022	4	3	1	Jo